

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Ministria e Brendshme fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektve “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2025-2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2025-2028”.

Ministria e Brendshme mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektaktit, kryesisht mbi: reduktimin e zotërimit dhe qarkullimit të paligjshëm të armëve, fuqizimin e mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit të veprimtarisë së lejuar me armë si dhe parandalimin, përmes ndërgjegjësimit të publikut, mbi rreziqet që lidhen me armëmbajtjen e paligjshme dhe dhunën me armë.

- Miratimi i kësaj Strategjie si pjesë e detyrimeve kombëtare dhe e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, për të përfunduar me sukses negociatat për Kapitujt 24 dhe 31 të acquis, duke kontribuar në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit të armëve.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të Projektaktit.

Ministria e Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë nga data 10 korrik 2025 deri në datën 7 gusht 2025.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrin Elektronik për projektaktin, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>:
- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinatorit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, Sara Shameti, në adresën: Sara.Shameti@mb.gov.al dhe Margarita.Vogli@mb.gov.al

Kontakti:

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

Znj. Sara Shameti - Koordinatore e Konsultimit Publik, e-mail: Sara.Shameti@mb.gov.al

Znj. Margarita Vogli - Përgjegjëse, Drejtoria e Politikave për Rendin dhe Sigurinë Publike, e-mail: Margarita.Vogli@mb.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 6, datë 14.04.2025, u krijua Grupi Ndërinstitucional i Punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2025–2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2025–2028, i kryesuar nga Zëvendësministri i Brendshëm dhe që në përbërje kishte anëtarë, përfaqësues të: Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme; Ministrisë së Drejtësisë; Ministrisë së Arsimit dhe Sportit; Ministrisë së Mbrojtjes; Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët; Prokurorisë së Përgjithshme; Strukturës së Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit; Agjencisë së Kontrollit Shtetëror të Eksporteve; Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës; Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Takimet e Grupit Ndërinstitucional të Punës janë koordinuar dhe bërë pjesë e agjendës së takimeve të Komisionit Kombëtar të Armëve të Vogla e të Lehta një mekanizëm koordinues ndërinstitucional në fushën e kontrollit të armëve të vogla e të lehta i ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr. 69, datë 22.05.2017. Në këtë kuadër takimi kryesor ishte takimi i 13-të i Komisionit Kombëtar të Armëve të Vogla e të Lehta i mbajtur në datë 12 qershor 2025, në ambientet e Hotel Rogner Tiranë, ku pjesë e rëndësishme e agjendës së tij u bë edhe diskutimi i draftit të parë të strategjisë dhe planit të ri veprimit pjesë e projektvendimit të Këshillit të Ministrave nga Grupi Ndërinstitucional i Punës i ngritur me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 6, datë 14.04.2025, përfshirë edhe përfaqësues nga institucionet e tjera të përfshira dhe organizatat ndërkombëtare. Plani i Veprimit i është përcjellë të gjitha organizatave që kanë projekte në fushën e kontrollit të armëve të vogla e të lehta, municioneve dhe eksplozivëve dhe që financohen dhe mbështesin institucionet shqiptare nën ombrellën e aktiviteteve të Udhërrëfyesit Rajonal për Kontrollin e Armëve të Vogla e të Lehta në Ballkanin Perëndimor 2025-2030 si UNODC, UNDP, OSBE, SEESAC, më datë 19.06.2025.

Sfondi i propozimit legjislativ

Projektakti i propozuar ka për qëllim miratimin e dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2025–2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2025–2028, i cili është përgatitur në vijim të Strategjisë Kombëtare për

Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019–2024 dhe Planit të saj të Veprimit.

Vizioni i strategjisë 6-vjeçare do të jetë që, brenda vitit 2030, Republika e Shqipërisë të jetë një vend me një mjedis të sigurt dhe me kapacitete gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, në përputhje me standardet më të larta të sigurisë publike dhe angazhimet ndërkombëtare, për të parandaluar, identifikuar, hetuar, ndjekur penalisht dhe ndëshkuar zotërimin e paligjshëm, trafikimin dhe keqpërdorimin e armëve të vogla dhe të lehta, municioneve dhe eksplozivëve, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe ato ndërkombëtare, duke kontribuar në forcimin e rendit dhe sigurisë publike, konsolidimin e sundimit të ligjit dhe garantimin e stabilitetit kombëtar dhe rajonal.

Në linjë me këtë vision, objektivat kryesorë strategjikë janë reduktimi i zotërimit dhe qarkullimit të paligjshëm të armëve; fuqizimi i mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit të veprimtarisë së lejuar me armë; si dhe parandalimi, përmes ndërgjegjësimit të publikut, mbi rreziqet që lidhen me armëmbajtjen e paligjshme dhe dhunën me armë. Gjithashtu, një komponent kyç i saj është vijimi i angazhimit për përafrimin e politikave kombëtare në fushën e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta, municioneve dhe eksplozivëve, duke marrë parasysh situatën e kërcënimeve të reja të sigurisë në rajon dhe standardet e BE-së, OKB-së dhe OSBE-së, si dhe Udhërrëfyesin Rajonal *“Për një zgjidhje të qëndrueshme për zotërimin e paligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të vogla dhe të lehta, municioneve dhe eksplozivëve në Ballkanin Perëndimor 2025–2030”*.

Propozimet

Projektakti vjen si nevojë e vazhdimësisë së proceseve të nisura me Strategjinë e mëparshme Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve, dhe përmirësimit të mëtejshëm të politikave, nëpërmjet plotësimit të mësimave të nxjerra, si dhe sfidave të hasura në adresimin e suksesshëm gjatë këtyre viteve.

Miratimi i kësaj Strategjie vjen edhe si pjesë e detyrimeve kombëtare dhe e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, për të përfunduar me sukses negociatat për Kapitullin 24: *Drejtësia, Liria dhe Siguria, për çështjet e luftës kundër krimit të organizuar dhe kundër terrorizmit, ku përfshihet edhe kontrolli i armëve të vogla e të lehta, municioneve dhe eksplozivëve*; dhe Kapitullin 31: *Politika e Jashtme, e Sigurisë dhe e Mbrojtjes, për çështjet e mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta, kuadri strategjik*.

Strategjia synon që Republika e Shqipërisë të jetë një vend me një mjedis të sigurt dhe me kapacitete të qëndrueshme për të parandaluar, kontrolluar dhe ndëshkuar keqpërdorimin,

trafikimin dhe zotërimin e paligjshëm të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe ato ndërkombëtare.

Pyetjet

Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projektaktit të propozuar. Për më tepër, ne kemi zgjedhur pyetjet e mëposhtme ku kontributi juaj do të jetë veçanërisht i vlefshëm, dhe të cilave mund t'i përgjigjeni duke plotësuar një pyetësor të shkurtër në internet.

1. A mendoni se objektivat dhe masat e parashikuara në Strategji janë të mjaftueshme për të garantuar reduktimin efektiv të qarkullimit të paligjshëm të armëve dhe forcimin e sigurisë publike në nivel kombëtar dhe lokal?
2. Cilat janë sipas jush mekanizmat më efektivë për të garantuar transparencën, llogaridhënien dhe përfshirjen e aktorëve të shoqërisë civile në zbatimin e kësaj Strategjie?
3. Cilat masa do ta përmirësonin dhe forconin bashkëpunimin e strukturave të policimit në komunitet dhe forcave ligjzbatuese me komunitetin me qëllim reduktimin e rasteve të dhunës me armë zjarri, veçanërisht tek të rinjtë dhe gratë dhe vajzave?